



Banka Popullore e  
Republikës së Maqedonisë  
së Veriut



Fondi European për  
Europën Juglindore

## **Strategjia fintek për rregulatorët financiarë, 2023-2027**

**Shfrytëzimi i mundësive dhe përfitimeve nga inovacionet  
teknologjike në sistemin financiar**

Prill, 2023



## Përmbajtja

### Hyrje

I.	Strategjia fintek për rregullatorët.....	6
1.	Motivi për Strategjinë fintek për rregullatorët .....	6
2.	Vizioni për sektorin fintek nga këndvështrimi i rregullatorëve .....	8
3.	Qëllimet strategjike dhe planet aksionare për të arritur vizionin e rregullatorëve.....	8
4.	Qasja e koordinuar e rregullatorëve për zbatimin e Strategjisë fintek për rregullatorët ....	11
5.	Korniza e udhëheqjes dhe mekanizmi për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve për rregullatorët .....	12
6.	Procesi i zbatimit të rekomandimeve për rregullatorë dhe dinamika e parashikuar kohore	14
7.	Rreziqet kryesore dhe sfidat në zbatimin e Strategjisë fintek për rregullatorët .....	15
8.	Mbikëqyrja dhe vlerësimi i progresit.....	16
	Shtojca: Programi me indikacionin dinamik kohor për zbatimin e rekomandimeve për rregullatorët.....	17

## Hyrje

Inovacionet teknologjike në fushën e financave, ose shkurtimisht “fintek”, janë shtytës i fuqishëm për rritjen e ekonomive dhe kanë potencial të madh për transformimin e shërbimeve financiare. Shkurtesa fintek, ashtu si dhe shumë shembuj tjerë të termeve të përgjithshme, mund të ketë kuptime të ndryshme varësisht nga konteksti. Ajo mund t’i referohet bizneseve fillestare ose kompanive të themeluara të cilat punojnë në sektorin financiar dhe kompanitë të cilat kanë modele biznesi të bazuara në teknologji inovative. Termi “fintek” gjithashtu mund t’i referohet vetë teknologjive, pa dallim nëse ato zbatohen nga kompani të reja, ose janë lëndë hulumtimi nga pjesëmarrësit tradicionalë të tregut, siç janë bankat <sup>1</sup>.

Duke marrë parasysh potencialin e teknologjive moderne dhe zbatimin e tyre në financa, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, (në tekstin e mëposhtëm: Banka Popullore) në vitin 2008 inicioi projekt për vendosjen e themeleve për transformimin e sistemit financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëposhtëm: RMV-ja), e kryesuar nga sektori i fintekut. Projekti u realizua përmes Fondit Europian për Europën Juglindore (në tekstin e mëposhtëm: EFSE-ja) që ofroi mbështetje financiare dhe ekspertizë.

Aktivitetet e projektit filluan në vitin 2018 me forcim të kapacitetit dhe vetëdijes së punonjësve të Bankës Popullore mbi rëndësinë e inovacionit në shërbimet financiare. Duke ndjekur shembullin e bankave qendrore të tjera, në vitin 2019 Banka Popullore krijoi një grup pune për teknologjitë financiare me ekspertë nga njësi të ndryshme organizative. Ky grup pune deri në fund të vitit e themeloi [Portën e Inovacionit](#), si platformë për komunikim me komunitetin inovativ të biznesit (në tekstin e mëposhtëm: Sektori fintek) dhe sigurimin e udhëzimeve në lidhje me rregullimin e licencimit të ideve të tyre të biznesit. Në atë periudhë, Banka Popullore së bashku me Ministrinë e Financave ishin të përfshira në mënyrë aktive në procesin e pajtueshmërisë së rregullativave për shërbimet pagesore dhe sistemet pagesore, me direktivat PSD2 të BE-së, EMD2, PAD, SFD, IFR dhe disa dispozita të rregullores së SEPA-s <sup>2</sup>.

Në fund të vitit 2019, të gjithë rregullatorët financiarë në RMV-në<sup>3</sup> (në tekstin në vijim: rregullatorë) e kanë konfirmuar nevojën e zhvillimit të sektorit të fintekut në RMV-në dhe janë

---

<sup>1</sup> Sipas Bordit të Stabilitetit Financiar termi “fintek” definohet si: “inovacion financiar i mundësuar teknologjikisht që mund të rezultojë në modele të reja biznesi, aplikacione, procese ose produkte me efekte të shoqëruara materiale në tregjet dhe institucionet financiare dhe ofrimin e shërbimeve financiare”.

<sup>2</sup> Me Ligjin e Shërbimeve Pagesore dhe Qarkullimit Pagesor është bërë harmonizimi me Direktivën 32015L2366 e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian për shërbimet pagesore në tregun e brendshëm (CELEX nr. 32015L2366), Direktiva 32009L0110 e, transferimin e llogarive pagesore dhe qasje deri të llogaritë pagesore me funksione bazë (CELEX nr. 32014L0092), Rregullorja 32015R0751 e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian për tarifën e zëvendësimit për transaksionet pagesore me kartelë (CELEX nr. 32015R0751) dhe Rregullorja 02012R0260-20140131 e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian dhe vendosjen e kërkesave Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian për para elektronike (CELEX nr. 32009L0110), Direktiva 01998L0026-20190627 e Parlamentit Europian dhe Këshilli i përfundimit të shlyerjes dhe sistemet e shlyerjes së letrave me vlerë (CELEX nr. 01998L0026-20190627) Direktiva 32014L0092 e Parlamentit Europian dhe Këshillit për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë pagesoretëknike dhe të biznesit për transfertat e kredisë dhe debitimet direkte në euro (CELEX nr. 02012R0260-20140131

<sup>3</sup>Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Financave, Komisioni i Letrave me Vlerë, Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimit dhe Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional.

dakorduar që në të ardhmen të miratohet Strategjia nacionale e fintekut, nëse tregohet se është e realizueshme. Megjithatë, ata vlerësuan se, përpara se të fillohet përgatitja e Strategjisë nacionale të fintekut, ekosistemi duhet të hartohet, të rishqyrtohen iniciativat e ndërmarra nga palët e interesit, të identifikohen përfitimet nga zhvillimi i sektorit fintek në vend dhe të rishqyrtohet çdo pengesë e mundshme për zhvillimin e tregut të shërbimeve financiare.

Për këtë qëllim pati qasje përmes hulumtimit gjithëpërfshirës të ekosistemit dhe gjatë muajit tetor 2020 u realizua anketë. Në anketë morën pjesë 220 të anketuar nga segmente të ndryshme të ekosistemit, ku shumica e tyre (90%) konfirmuan nevojën për transformimin e sistemit financiar në RMV-së, të udhëhequr nga sektori i fintekut. Gjetjet nga hulumtimi i anketës treguan se inovacioni teknologjik në fushën e financave sjellin përfitime të konsiderueshme për konsumatorët dhe bizneset e vogla. Modernizimi dhe harmonizimi i sistemit financiar me praktikën më të mira ndërkombëtare mund të ndihmojë RMV-në në procesin e integritimit në BE. Sektori i fintekut gjithashtu ka prirje të rrisë përfshirjen financiare. Hulumtimi gjithashtu theksoi rreziqet kryesore, sfidat dhe pengesat rregullatore që kufizojnë zhvillimin e tregut të shërbimeve financiare. Në bazë të rezultateve të anketës hulumtuese është përgatitur [Studimi për vlerësimin e realizueshmërisë së fintekut në RMV](#).

Në korrik të vitit 2021, u miratua vendimi për vazhdimin e projektit me EFSE-në me qëllim të zhvillimit të Strategjisë fintek për RMV-në (në tekstin e mëtejme: Strategjia nacionale fintek). Bartëse e projektit ishte edhe një herë Banka Popullore, e cila mundësoi takime koordinuese dhe konsultative me palët e interesuara nga ekosistemi fintek, udhëheqi aktivitetet dhe kontribuoi në përgatitjen e të gjitha dokumenteve.

Për të siguruar pavarësinë e rregullatorëve dhe ndarjen e duhur të aktiviteteve, qëllimet dhe interesat e rregullatorëve nga ato të palëve të tjera të interesuara, u përpiluan dy dokumente strategjike, të cilat së bashku përbëjnë Strategjinë nacionale fintek:

- 1) Strategjia fintek për rregullatorët financiarë (në tekstin e mëtejme: Strategjia fintek për rregullatorët
- 2) Strategjia për inovacionet dhe sipërmarrjet fintek (në tekstin e mëtejme: Strategjia për sipërmarrësit fintek).

*Përcaktimi i Strategjisë nacionale fintek përfaqëson përfundimin e aktiviteteve të projektit të EFSE-së për vënien e themeleve për transformimin e sistemit financiar në RMV-në i udhëhequr nga sektori fintek. Strategjia nacionale fintek paraqet dokument strategjik që bazohet në premisën se transformimi i sistemit financiar në RMV-në, e udhëhequr nga sektori fintek, nuk do të mund të ishte e suksesshme pa qasje të koordinuar të të gjitha palëve të interesuara në ekosistem.*

## I. Strategjia fintek për rregullatorët

Strategjia fintek për rregullatorët i referohet aspekteve rregullatore që lidhen me transformimin e sistemit financiar të udhëhequr nga sektori fintek. Kjo pjesë i përmban rekomandimet për rregullatorët dhe ofron pasqyrë të kuadrit të udhëheqjes në vend, që siguron qasje të koordinuar të rregullatorëve dhe mekanizëm të përshtatshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve nga Strategjia fintek për rregullatorët.

### 1. Motivi për Strategjinë fintek për rregullatorët

Përfitimet e zhvillimit të inovacioneve në financa janë të shumfishta, kjo është arsyeja pse ato përfaqësojnë nxitje për të ndërmarrë aktivitete për zbatimin e transformimit të sistemit financiar, të udhëhequr nga sektori fintek. Sipas Raportit të Grupit të ekspertëve të BE-së për pengesat rregullatore që lidhen me inovacionet financiare (ROFIEG)<sup>4</sup>, zhvillimi i inovacioneve në sferën e financave mund të sjellë katër përfitime:

1. Pjesëmarrësit e tregut mund të ofrojnë shërbime financiare me çmim më të ulët;
2. Pjesëmarrësit e tregut mund të zhvillojnë gamë më të gjerë produktesh dhe shërbimesh, e cila do të zgjerojë zgjedhjen e konsumatorëve dhe kompanive, dhe nëpërmjet kësaj, potencialisht do të ofrohen mundësi më të mira financimi;
3. Disa produkte ose shërbime mund të afrohen me konsumatorët ose kompanitë;
4. Sektori fintek mund të përdoret për të arritur rregullim më efektiv dhe harmonizim me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Megjithatë, ROFIEG-ja thekson se përfitimet e sektorit fintek nuk mund të realizohen plotësisht nëse kuadri rregullator është i paqartë, i fragmentuar ose mungon. Në Europë, ROFIEG-ja është e qëndrimit se harmonizimi dhe qartësimi i masave rregulluese dhe mbikëqyrëse do të ofrojë mjet efektiv për të mbështetur zhvillimin e sektorit fintek në BE.

Përvoja ndërkombëtare tregon se tregjet e shërbimeve financiare thellohen me rritjen e sigurisë rregullatore. Rrjedhimisht, siguria rregullatore i inkurajon sipërmarrësit t'i plasojnë ndërmarrjet ose produktet e tyre dhe u siguron atyre besim. Në mënyrë të ngjashme, investitorët janë më të gatshëm të financojnë ide inovative kur rreziku i pasigurisë rregullatore hiqet ose është i papërfillshëm. Në të njëjtën kohë, sektori privat është më i gatshëm të bashkëpunojë me kompanitë e reja fintek, nëse ato janë zyrtarisht të rregulluara, dhe të drejtat e konsumatorëve janë të mbrojtura.

Pengesat rregullatore mund të parandalojnë disa ide inovative të shfaqen në treg. Prandaj, ndërhyrja nga ana e rregullatorëve e cila mundëson përcaktimin e pengesave dhe heqjen ose lehtësimin e kërkesave të gjera rregullatore për kompanitë, të cilat janë në fazë të hershme të zhvillimit të tyre dhe që nuk kanë mjete financiare, paraqet parakusht të rëndësishëm në evolucionin e tregut fintek. Fleksibiliteti dhe hapja ndaj ndryshimit të mjedisit rregullator tregon

---

<sup>4</sup>Grupi i ekspertëve të BE-së për pengesat rregullatore që lidhen me inovacionet financiare (ROFIEG): "[30 rekomandime për rregullim, inovacion dhe financa](#)", dhjetor, 2019, fq. 10.

se pengesat rregullatore do të hiqen për të inkurajuar inovacionin dhe se rregullatorët mundësojnë mbështetje për inovatorët dhe kompanitë e fazës së hershme.

[Studimi për vlerësim të realizueshmërisë së fintekut në RMV](#) tregon për përfitime të ngjashme si ato të Raportit të ROFIEG-ut, por edhe të tjera. Më konkretisht, në rastin e RMV-së, të anketuarit në Anketë theksojnë përfitimet e mëposhtme nga sektori fintek:

- Modernizimin e sistemit financiar sipas prirjeve të reja, si dhe modernizimi i rregulloreve ligjore;
- Më shumë zgjedhje, më shumë përfitime dhe aftësi për të menaxhuar më mirë financat personale duke përdorur kanale digjitale;
- Harmonizimin e sistemit financiar të RMV-së me praktikën më të mira ndërkombëtare, përmes të cilave integrimi i dëshiruar i vendit me BE-në bëhet më i sigurt;
- Përmirësimin e efikasitetit të sistemit financiar, me mundësinë e konvertimit të shpenzimeve më të ulëta në produkte financiare më të lira;
- Rritjen e qasjes në financa për individët dhe bizneset e vogla të cilat nuk ofrohen në mënyrë efektive nga institucionet tradicionale financiare;
- Rritja e konkurrencës në sistemin financiar (duke lejuar hyrjen e pjesëmarrësve të rinj në treg) e cila mund të sjell më shumë zgjedhje dhe mundësi më të mira për klientët.

Sipas përgjigjeve të grupeve të ndryshme të të anketuarve që morën pjesë në Anketë, rregullativa është një nga sfidat më të rëndësishme për inovatorët e shërbimeve financiare. Pa siguri rregullatore, inovatorët shpesh herë nuk janë të gatshëm të sjellin produkte dhe shërbime të reja në treg. Huluntimi anketues ka treguar se rregullativa aktuale nuk është në pajtueshmëri me disa nga modelet e reja të biznesit nga sektori fintek, siç është huazimi i parave personave fizik ose kompanive që lidhin huadhënësit me huamarrësit përmes shërbimeve onllajn, platformat për financim në grup, ose ofruesit e shërbimeve të inicimit të pagesave nga palët e treta (ky model biznesi mund të zhvillohet me fillimin e zbatimit të [Ligjit të ri të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore](#)).

Inovatorët shprehin dëshirën për hapje dhe mbështetje më të madhe nga rregullatorët, me çka do të rritet besimi tek ata dhe do të jenë të mbështetur në procesin e krijimit të risive në tregun e shërbimeve financiare.

Rregullatorët në RMV janë të dakorduar se sektori fintek mund të nxit konkurrencën, dhe në këtë mënyrë të përmirësojë nivelin e cilësisë së shërbimeve financiare dhe të sigurojë qasje më të madhe dhe më të thjeshtë në financa. Përmes Portës së Inovacionit në Bankën Popullore arrijnë pyetje nga më shumë palë të interesuara nga vendi dhe nga jashtë, të cilët kërkojnë udhëzime rregullatore për licencimin. Rregullatorët, gjithashtu, e mbështesin krijimin e një mjedisi rregullator (angl. Regulatory Sandbox), i cili lejon testimin e ideve inovative të biznesit, dhe gjithashtu ofron mundësi për të kuptuar modelet e reja të biznesit që vijnë në tregjet financiare dhe mënyrën e rregullimit të tyre.

## 2. Vizioni për sektorin fintek nga këndvështrimi i rregullatorëve

Strategjia fintek për rregullatorët ka vizionin vijues:

1. Fleksibilitet dhe hapje ndaj ndryshimeve në kuadrin rregullator me qëllim të nxitjes së konkurrencës në interes të konsumatorëve dhe të sistemit financiar;
2. Inkurajimin e inovacionit në sistemin financiar, në interes të individëve dhe kompanive, duke identifikuar dhe hequr pengesat rregullatore;
3. Rritjen e elasticitetit dhe stabilitetit të sistemit financiar. Me përdorimin e zgjidhjeve inovative fintek të arrihet efikasitet më i lartë operacional, menaxhim më i mirë i rrezikut dhe harmonizim më të mirë rregullator të institucioneve financiare.

## 3. Qëllimet strategjike dhe planet aksionare për të arritur vizionin e rregullatorëve

Realizimi i vizionit për sektorin fintek nga këndvështrimi i rregullatorëve nënkupton zbatimin e disa rekomandimeve me plane të detajuara aksionare.

### 1. Krijimi i mjedisit rregullator për bankat dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve financiare në RMV, të favorshëm për inovacionin, sipërmarrjen dhe konkurrencën në interes të përfshirjes financiare dhe stabilitetit financiar.

a. Krijimi i Qendrës së Inovacionit nga rregullatorët Cross - Regulatory Innovation Hub).

### 2. Krijimi i mjedisit për testimin e zgjidhjeve inovative përpara futjes së tyre në tregun e shërbimeve financiare (sendboks). Disa modele inovative biznesi mund të mos mbulohen nga kuadri aktual rregullator, me ç'rast mund të testohen në mjedis të kontrolluar, nën mbikëqyrje dhe pa sanksione nga rregullatorët.

a. Krijimi i mjedisit testues rregullator, si mjet për testimin e funksionalitetit të zgjidhjeve inovative në mjedis rregullator të kontrolluar.

### 3. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar i rregullatorëve. Nxitja e bashkëpunimit me rregullatorë të tjerë nga rajoni, si dhe me institucionet përkatëse ndërkombëtare ka për qëllim përshpejtimin e zhvillimit të sektorit fintek përmes shkëmbimit të ideve dhe lehtësimit të daljes së kompanive vendase fintek në tregje më të mëdha jashtë vendit (zgjerim ndërkufitar).

a. Nxitja e bashkëpunimit formal dhe joformal rajonal dhe ndërkombëtar dhe përfundimi i marrëveshjeve.

### 4. Rregullimi i strukturës organizative pranë rregullatorëve për zhvillimin dhe mbështetjen e inovacioneve në sistemin financiar, pa rrezikuar kryerjen e funksioneve të tyre kryesore, përfshirë kompetencat mbikëqyrëse.

a. Rregullatorët e rishikojnë dhe rinovojnë strukturën e tyre organizative në mënyrë që ata të mund t'i përgjigjen pozitivisht dhe me kapacitet adekuat zhvillimit



dhe mbështetjes së inovacioneve në sistemin financiar, duke u kujdesur që të mos rrezikohet funksionimi aktual.

**5. Ngritja e kapaciteteve të rregullatorëve.** Rregullatorët kanë njohuri dhe kapacitetin e duhur për të mbështetur sektorin fintek.

a. Rregullatorët zhvillojnë dhe zbatojnë programe trajnimi dhe ngritjeje kapacitetesh për punonjësit.

**6. Kuadër i përshtatur për mbrojtjen e konsumatorëve të shërbimeve financiare.** Kuadri i mbrojtjes së Konsumatorit të shërbimeve financiare ofron siguri për konsumatorët kur përdorin produkte dhe shërbime digjitale inovative.

a. Vlerësimi i aftësisë së përshtatjes të kuadrit rregullator për mbrojtjen e konsumatorëve për shërbimet e reja financiare të bazuara në fintek.

b. Vlerësimi i mundësisë së themelimit të Avokatit të Popullit për shërbime financiare.

**7. Vlerësimi i pengesave rregullatore** - Të përcaktohet dhe rivlerësohet justifikimi i ekzistencës së kërkesave rregullatore, të cilat janë kufizuese për zhvillimin e subjekteve fintek në fazën e hershme të zhvillimit të tyre.

a. Rregullatorët vlerësojnë pengesat rregullatore për zhvillimin e sektorit fintek, hartojnë strategji për të reduktuar kërkesat rregullatore ose mospajtueshmëritë në kuadrin rregullator.

**8. Qasja proaktive e rregullatorëve në lidhje me shfaqjen e modeleve të reja të biznesit.** Rregullatorët duhet të njohin modelet e reja të biznesit të bazuara në fintek, në mënyrë që ata të mund të përshtatin qasjen rregullatore ndaj ideve të tilla inovative dhe të përshpejtojnë ndryshimin e kryesuar nga inovacioni në shërbimet financiare.

a. Rregullatorët munden, nëpërmjet hulumtimit dhe bashkëpunimit me rregullatorë të tjerë, të identifikojnë dhe të kuptojnë modelet e reja të biznesit të bazuara në fintek që mund të shfaqen në RMV. Në pajtim me rrethanat, ata mund të rregullojnë në mënyrë proaktive kuadrin rregullator për të siguruar kushte për shfaqjen e këtyre modeleve të biznesit në tregun vendas.

**9. Vlerësimi i rreziqeve të fintekut.** Përveç mbështetjes së konkurrencës dhe inovacionit, aktivitetet e rregullatorëve duhet të synojnë njohjen në kohë dhe gjithëpërfshirëse dhe vlerësimin e rreziqeve të ndikimit të inovacioneve në shërbimet financiare mbi stabilitetin e sistemit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit.

a. Rregullatorët në baza të rregullta kryejnë vlerësim gjithëpërfshirës të rrezikut për të vlerësuar ndikimin e mjedisit rregullator më të hapur në inovacionin dhe konkurrencën e drejtuar nga teknologjia financiare.

**10. Sigurimi i qartësisë rregullatore dhe konsistencës në zbatimin e ligjeve dhe rregullore të tjera që kanë ndikim në zhvillimin e sektorit fintek.** Pritet që rregullorja e qartë të stimulojë dinamikën e zhvillimit të shërbimeve financiare digjitale dhe produkteve fintek.

a. Rregullatorët ofrojnë udhëzime të përshtatshme rregullatore përmes të cilave do të jetë e mundur zbatimi korrekt, i qartë dhe konsekuent i disa dispozitave ligjore dhe nënligjore të cilat kanë ndikim në zhvillimin e teknologjisë financiare.

**11. Raporti i identifikimit të sfidës post-pandemike dhe të kuptuarit e mundësive që ofron zhvillimi i sektorit fintek.** Pandemia e shkaktuar nga virusi covid-19 theksoi ekzistencën e disa pengesave për zhvillimin e shërbimeve financiare digjitale. Duke vlerësuar ndikimin e pandemisë në zhvillimin e shërbimeve financiare digjitale, duhet të identifikohen pengesat, por edhe mundësitë për zhvillimin e zgjidhjeve inovative në fushën e financave.

a. Rregullatorët po përgatisin raport mbi ndikimin e pandemisë covid-19 mbi sistemin financiar, zhvillimin e shërbimeve inovative financiare digjitale.

**12. Heqja e pengesave për institucionet pagesore jobankare.** Ofruesit e shërbimeve pagesore jobankare nuk duhet të përballen me sfida rregullatore, tregtare ose operacionale, të cilat parandalojnë prezantimin e zgjidhjeve inovative dhe ekonomike për pagesat, në interes të konsumatorëve, bizneseve të vogla dhe e-tregtarëve. Heqja e pengesave është parakusht që më shumë ofrues të shërbimeve pagesore të hyjnë në treg.

a. Banka Popullore do të vlerësojë pengesat praktike dhe rregullatore të cilat ekzistojnë për ofruesit pagesor jobankar pas fillimit të zbatimit të kuadrit të ri rregullator të pagesave dhe do të vlerësojë nevojën për tejkalimin e tyre.

**13. Transferim i shpejtë dhe i thjeshtë i llogarive pagesore të konsumatorëve nga institucionet financiare tradicionale tek subjektet e reja fintek.** Procedura e shpejtë dhe e lehtë do të mundësojë eksperiencë më të mirë të përdoruesit për klientët, më shumë zgjedhje dhe çmime më të ulëta të shërbimeve financiare.

a. Rregullatorët duhet të përcaktojnë pengesat për transferimin më të lehtë të llogarive të klientëve (për shembull, pengesat administrative që pengojnë klientin të ndryshojë llogarinë) dhe të ndërmarrin veprimet e duhura për t'i kapërcyer ato.

**14. Bashkëpunimi i rregullatorëve me komunitetin fintek.** Rregullatorët po bashkëpunojnë me komunitetin fintek në procesin e përpilimit të rregullores në mënyrë që ata të kuptojnë më mirë inovacionet financiare dhe mjedisi i kompanive të sapolindura fintek. Në këtë mënyrë, rregullatorët u përgjigjen më mirë nevojave të tregut dhe të marrë qëndrim proaktiv ndaj ndryshimeve rregullatore, për t'iu përshtatur modeleve të reja të biznesit fintek, produkteve ose shërbimeve fintek.

- a. Krijimi i forumit për komunikim me komunitetin fintek, shoqatat, investitorët, institucionet arsimore, ofruesit e shërbimeve teknologjike;
- b. Rregullatorët përcaktojnë plane me aktivitete specifike për bashkëpunim të rregullt me komunitetin fintek.

**15. Planet për trajtimin e rregullt të kompanive fintek nëse ato dështojnë ose dalin nga tregu.** Planet synojnë të minimizojnë dëmin ndaj konsumatorëve, të kufizojnë rrezikun e infektimit në sektorin fintek dhe të kufizojnë efektet negative në sektorin e përgjithshëm financiar, në rast se kompania e re ose produkti i ri përfundon me dështim.

- a. Rregullatorët duhet të konsiderojnë futjen e kërkesës rregullatore për përpunimin e planeve për trajtimin e duhur me kompanitë fintek nëse dështojnë ose dalin nga tregu. Këto plane do të rishikoheshin në procedurën e licencimit të tyre dhe do të realizohej vlerësim pasues mbikëqyrës i tyre.

**16. Financa të hapura** - Rregullorja e bën më të lehtë për institucionet financiare hapjen e të dhënave të klientëve (me pëlqimin e tyre) palëve të treta të licencuara që ofrojnë shërbime me vlerë të shtuar dhe u mundëson konsumatorëve dhe bizneseve të menaxhojnë më mirë financat e tyre ose të kryejnë transaksione në mënyrë efikase.

- a. Rregullatorët dhe ministritë kompetente nga Qeveria e RMV-së duhet të shqyrtojnë mundësinë e zhvillimit të një kuadri rregullator dhe biznesi për financa të hapura.

**17. Rregullatorë efikasë dhe efektivë me ndihmën e përdorimit të teknologjisë.** Rregullatorët janë më efektiv dhe më efikas duke përdorur zgjidhje teknologjike dhe mund të përmirësojnë mbikëqyrjen e institucioneve të sistemit financiar.

- a. Rregullatorët hulumtojnë se si të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin përmes adoptimit të zgjidhjeve teknologjike siç janë "suptek" (Suptech) dhe "rektek" (Regtech).

**18. Rregullatorët i kuptojnë pasojat e futjes të valutës digjitale të bankës qendrore (angl. CBDC) për sektorin fintek.** Respektivisht, i definojnë strategjitë e nevojshme me qëllim t'i shfrytëzojnë mundësitë dhe t'i zbusin rreziqet nga futja e valutës digjitale të bankës qendrore.

- a. Mundësitë, sfidat dhe ndikimi i valutës digjitale të bankës qendrore (angl. CBDC) mbi zhvillimin e sektorit fintek janë të qarta dhe të kuptueshme.

#### 4. Qasja e koordinuar e rregullatorëve për zbatimin e Strategjisë fintek për rregullatorët

Me qëllim mbështetjen e zhvillimit të inovacioneve në shërbimet financiare në vend nevojitet qasje e koordinuar nga autoritetet rregullatore të sistemit financiar - rregullatorëve. Për rrjedhojë, rregullatorët përgjegjës për segmentet e veçuara të sistemit financiar: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (BPRMV), Ministria e Financave (MF), Komisioni i Letrave me Vlerë (KLV), Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS), Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit

Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS), në mars të vitit 2022 nënshkruan Memorandum për bashkëpunim për formimin e kushteve për mbështetjen e zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar në RMV-në.

Qëllimi kryesor i Memorandumit është të ofrojë kushte për të mbështetur inovacionin, konkurrencën dhe qasjen në financa, duke pasur parasysh mbrojtjen e konsumatorëve dhe investitorëve dhe mbrojtjen e sistemit financiar në tërësi. Bashkëpunimi që krijohet me nënshkrimin e Memorandumit i referohet zhvillimit dhe zbatimit të rekomandimeve që janë përgjegjësi e rregullatorëve, dhe që do të jenë pjesë përbërëse e Strategjisë nacionale fintek.

Një nga mekanizmat bazë të bashkëpunimit të rregullatorëve gjatë komunikimit me sektorin fintek është krijimi i Qendrës të Përbashkët të Inovacionit dhe mjedisit rregullator për testimin e modeleve inovative të biznesit (sendboks). Dokumenti me rekomandime të detajuara të fintekut për rregullatorët përmban përpunim të detajuar të këtyre dy mekanizmave të komunikimit me sektorin fintek, të cilat kanë prioritet të lartë në zbatim.

Bashkëpunimi i rregullatorëve ofron disa përparësi:

- **Proces me të thjeshtëzuar dhe më efikas të licencimit të pjesëmarrësve të rinj në tregun financiar.** Përpara se të vazhdohet me dorëzimin formal të kërkesës për licencim tek rregullatori kompetent, subjektet e interesuara mund të kontaktojnë Qendrën e Inovacionit dhe të sigurojnë informacionet e nevojshme në lidhje me dokumentacionin dhe procedurën e licencimit. Shpesh, rregullativa komplekse dhe hapat e komplikuar për licencim paraqesin faktor ndërlikues gjatë fillimit të biznesit të ri, veçanërisht për kompanitë e vogla. Pikërisht roli i Qendrës së Përbashkët të Inovacionit është të lehtësojë futjen e subjekteve të reja, duke ofruar këshilla juridike të padetyrueshme dhe t'i drejtojë subjektet e interesuara drejt rregullatorëve kompetentë dhe institucioneve të tjera, nëse kjo është e nevojshme. Rëndësia e bashkëpunimit dhe koordinimit të përbashkët ndërmjet rregullatorëve është veçanërisht e dukshme kur modeli i biznesit të një subjekti të caktuar është subjekt i rregullimit dhe licencimit nga disa rregullatorë.
- **Konvergjencia e praktikave mbikëqyrëse dhe ngritja e kapaciteteve të rregullatorëve.** Çdo rregullator mund të jetë në nivel të ndryshëm zhvillimi, me nivel të ndryshëm kapaciteti dhe njohurish. Prandaj, inovacioni kushtëzohet drejtpërdrejt nga kapaciteti i rregullatorit, respektivisht, gatishmëria dhe aftësia për t'u angazhuar me subjektet inovative fintek. Bashkëpunimi i rregullatorëve përmes Qendrës së Përbashkët të Inovacionit dhe mjedisit rregullator (angl. sandbox) do të mundësojë përafrimin e praktikave mbikëqyrëse dhe unifikimin e nivelit të zhvillimit të rregullatorëve.


#### 5. Korniza e udhëheqjes dhe mekanizmi për mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve për rregullatorët

Bazuar në qasjen e koordinuar të rregullatorëve financiarë për zbatimin efikas të rekomandimeve nga Strategjia është **Memorandumi i bashkëpunimit për krijimin e kushteve për të mbështetur zhvillimin e inovacioneve në sistemin financiar në RMV.**

Me nënshkrimin e Memorandumit, rregullatorët marrin përsipër angazhime specifike për zbatimin e duhur dhe në kohë të rekomandimeve të përcaktuara nga Strategjia, për të ofruar kushte për të mbështetur inovacionin, konkurrencën dhe qasjen në financa, duke pasur parasysh mbrojtjen e konsumatorëve dhe investitorëve dhe mbrojtjen e sistemit financiar në tërësi.

Për këtë qëllim, është krijuar strukturë e përshtatshme udhëheqëse dhe organizative në nivel të rregullatorëve, e cila përfshin formimin e:

1. Komitetit për mbështetjen e zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar në RMV - **Komiteti për fintek**, si organ kryesor koordinues dhe mbikëqyrës ndërinstitucional për sjelljen dhe miratimin e rekomandimeve të Strategjisë. Komiteti për fintek ofron udhëzime dhe rekomandime për organet dhe grupet e tjera të punës, bashkëpunon dhe shkëmben informacione me të gjitha palët e interesuara në vend dhe trupat dhe organizatat ndërkombëtare, kryen vlerësim të rreziqeve që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive financiare, duke përfshirë rreziqet për konsumatorët dhe investitorët dhe propozon aktivitete për zbutjen dhe/ose parandalimin e atyre rreziqeve. Në punën e Komitetit për fintek marrin pjesë përfaqësuesit më të lartë nga çdo rregullator, dhe puna e tij rregullohet me Memorandumin për bashkëpunim dhe me Rregulloren përkatëse të punës.
2. Nënkomiteti për mbështetje gjatë zbatimit të rekomandimeve nga Strategjia - **Nënkomiteti**, i cili në emër të Komitetit për fintek kujdeset për zbatimin operacional të kësaj strategjie në tërësi dhe për raportim të rregullt për progresin e arritur. Ky nënkomitet përpilon plan të detajuar për zbatimin e rekomandimeve të Strategjisë, në kornizë kohore të përshtatshme për zbatimin e tyre, vlerësimin e mënyrave të mundshme për zbatimin e rekomandimeve në praktikë, dhënien e rekomandimeve për ngritjen e grupeve të veçanta të punës dhe përdorimin e burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me palët e interesuara. Në punën e Nënkomitetit për fintek, marrin pjesë udhëheqës përkatës strategjikë ose taktikë nga çdo rregullator, dhe puna e tij rregullohet me Memorandumin për bashkëpunim dhe me Rregulloren përkatëse të punës.
3. **Grupet** e veçanta **të punës** që do të kenë për detyrë të punojnë në rekomandime të veçanta dhe të cilat për aktivitetet e ndërmarra, analizat e realizuara dhe hulumtimet e tjera të dokumentuara për zbatimin e rregullt të rekomandimeve në praktikë, do t'i raportojnë Nënkomitetit.
4. **Sekretariati** për ofrimin e mbështetjes administrative për operacionet e Komitetit për Fintek dhe të Nënkomitetit (**Sekretariati**), i cili mundëson mbështetje administrative të punës të Komitetit për fintek, Nënkomiteti dhe grupet e punës, me përgjegjësi për koordinimin e aktiviteteve, organizimin e mbledhjeve të komiteteve dhe grupeve të punës, mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura dhe dorëzimin e rregullt të raporteve deri te komisionet. Metoda e punës së Sekretariatit rregullohet nga Memorandumi i bashkëpunimit dhe me rregulloret e duhura të procedurës për punën e Komitetit për fintek dhe të Nënkomitetit.



## 6. Procesi i zbatimit të rekomandimeve për rregullatorë dhe dinamika e parashikuar kohore

**Strategjia fintek për rregullatorët** është lëndë e miratimit nga Komiteti për fintek i cili ka përgjegjësinë përfundimtare për zbatimin efikas dhe në kohë të rekomandimeve të strategjisë. Duke pasur parasysh se ky Komitet ka kryesisht rol mbikëqyrës, parashihet që aktivitetet e rregullta për zbatimin e rekomandimeve të realizohen nga grupe të veçanta punuese me pjesëmarrjen e ekspertëve nga rregullatorët, puna e të cilëve do të koordinohet dhe mbikëqyret nga Nënkomiteti. Për të arritur shkallë më të lartë të efikasitetit, parashikohet mundësia e angazhimit të ekspertëve (vendas ose të huaj) të cilët mund të përfshihen në zbatimin e rekomandimeve të caktuara. Detyra e Nënkomitetit është të vlerësojë nevojën për krijimin e grupeve të punës, të përcaktojë profilin e personave profesional që potencialisht do të përfshiheshin në punë për rekomandim të veçantë ose grup rekomandimesh nga Strategjia dhe të paraqesë propozim të duhur për miratim nga Komiteti për fintek.

Pasi formohet grupi i punës dhe do të përcaktohen personat profesional për zbatimin e rekomandimeve të caktuara, Nënkomiteti i fut në punë përmes shpjegimit të rekomandimit, angazhimit e nevojshëm dhe qëllimet që duhen arritur nëse rekomandimi zbatohet në kohë dhe në mënyrë efikase. Duke pasur parasysh se mund të ketë lidhje të disa rekomandimeve, nëse ka nevojë Nënkomiteti mund të ndajë Strategjinë për fintek për rregullatorët në tërësi së bashku me Dokumentin e rekomandimeve të detajuara për rregullatorët, me personat nga grupi i caktuar i punës.

Çdo grup pune ka për detyrë të analizojë rekomandimin, sipas nevojës të kryejë hulumtime shtesë në mënyrë që të mbulohen të gjitha aspektet e mundshme të fushës së lëndës dhe të dorëzojë

raport të dokumentuar për punën e tij deri te Nënkomiteti. Për çdo rekomandim parashikohet që grupi i punës të ketë të drejtën të ndërmarrë tre opsionet e mëposhtme:

1. Të pranojë rekomandimin, duke i dhënë grupit të punës mundësinë për të shtuar aspekte shtesë për të ndihmuar në zbatim.
2. Të ndryshojë rekomandimin, në mënyrë që të jetë materialisht i ndryshëm nga ai që u propozua fillimisht. Megjithatë, edhe pse mundësia e tillë është dhënë, kërkohet miratimi i duhur nga Komiteti për fintek, pas miratimit paraprak nga Nënkomiteti.
3. Të refuzojë rekomandimin me arsyetimin e duhur. Nëse merret qëndrim për të refuzuar rekomandimin, raporti i dokumentuar i grupit të punës duhet të miratohet nga Komiteti për fintek, pas miratimit paraprak nga Nënkomiteti. Grupi i punës ka të drejtë të rekomandojë rrjedhë tjetër të aktiviteteve ose të sygjerojë rekomandim tjetër i cili duhet të shqyrtohen dhe miratohet nga Komiteti për fintek.

Për secilin rekomandim është dhënë sistem i pikëve dhe prioritet në zbatim. Rezultatet e pikëve dhe ndërvarësia e rekomandimeve mundësojnë përcaktimin e afatit kohor për zbatimin e rekomandimeve (shtojca: Programi me indikacionin dinamik kohor për zbatimin e rekomandimeve). Megjithatë, afati kohor i përcaktuar paraqet kornizë indikative gjatë së cilës grupet e punës vlerësojnë nëse afati kohor i propozuar është i mjaftueshëm për të përmbushur rekomandimin ose do të propozojnë rishikimin e afatit.

Përmbushja e detyrave të grupeve të punës dhe raportet për arritjet e tyre i ndjek Nënkomiteti, ndërsa për kërkesat e mundshme për zgjatjen e afateve treguese kërkohet arsyetimi i duhur.

## 7. Rreziqet kryesore dhe sfidat në zbatimin e Strategjisë fintek për rregullatorët

Dokumenti me rekomandimet e detajuara për rregullatorët përmban elaborim të detajuar të rreziqeve, sfidat dhe aktivitetet e propozuara. Si pjesë integrale e Strategjisë fintek për rregullatorët është edhe Udhëzues për vlerësimin e rrezikut që rezultojnë nga inovacionet e bazuara në kompanitë fintek, i cili synon të ndihmojë rregullatorët në identifikimin, vlerësimin, matjen, zbutjen dhe mbikëqyrjen e rreziqeve që dalin nga inovacionet e bazuara në fintek.

Rregullatorët, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në strukturën udhëheqëse të përcaktuar me këtë strategji, duhet të marrin parasysh llojet e ndryshme të rreziqeve dhe të zhvillojnë në mënyrë proaktive strategji për të zbutur pasojat e tyre tek përdoruesit e shërbimeve financiare, institucionet financiare, sistemin financiar në tërësi.

## 8. Mbikëqyrja dhe vlerësimi i progresit

Struktura udhëheqëse e krijuar nga Strategjia fintek për rregullatorët duhet të sigurojë mbikëqyrjen e të gjitha nismave të zbatimit, por edhe marrjen e veprimeve të duhura, nëse vërehen vështirësi në zbatimin e rekomandimeve.

Për të mundësuar mbikëqyrjen e progresit në përmbushjen e rekomandimeve, për çdo rekomandim, të ashtuquajturit tregues kryesorë të performancës (angl. key performance indicators - KPIs) dhe të ashtuquajturit tregues kryesorë të rrezikut (angl. key risk indicators - KRIs). Këta tregues mund t'u shërbejnë grupeve të punës si indikacione udhëzuese, ku mund të përcaktojnë edhe tregues të tjerë për matjen e rezultateve. Pasi të vendosin se cilët indikacione treguese të kësaj strategjie do t'i zbatojnë ose do të vendosin të zbatojnë tregues të tjerë për matjen e rezultateve, grupet e punës i raportojnë rregullisht Nënkomitetit për progresin.

Në kushte ideale, çdo grupë e punës, dorëzon raporte mujore përmes Sekretariatit deri te Nënkomiteti.

Nënkomiteti përgatit raport për progresin në zbatimin e rekomandimeve të cilin e dorëzon deri te Komiteti për fintek një herë në gjashtë muaj, ose më shpesh nëse është e nevojshme.



